

## READING AND THE IMPORTANCE IT BEARS ON ESTABLISHING COMMUNICATION LEXIMI DHE RËNDËSIA E TIJ PËR ARRITJEN E KOMUNIKIMIT

Farketa DIBRA-ZEQIRI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" - Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare - Shkup

<sup>2</sup>E-mail: farketadibra@gmail.com

---

### Abstrakt

Me anë të kësaj kumtese synojmë të paraqesim rëndësinë që luan leximi si një ndër katër aftësitë më të rëndësishme të gjuhës, krahas të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit, i cili ndikon tej mase në zhvillimin dhe rritjen e aftësisë së komunikimit të nxënësit. Në Kurrikulën e Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë, fusha *Gjuhë dhe komunikim* zë një vend të veçantë, andaj brenda kumtesës mëtojmë të pasqyrojmë në mënyrë tabelore sasinë e orëve dhe shpërndarjen e njohurive të kësaj fushe për katër vitet mësimore, për shkollat e mesme, drejtimi gjimnaz i përgjithshëm. Kjo paraqitje tabelore do të na shërbejë për bërë krahasime mes sasisë së orëve dhe linjave dhe nënlinjave të paraqitura brenda fushës *Gjuhë dhe komunikim*. Krahasimi i një natyre të tillë, do të diktojë përfundimet dhe sugjerimet, se sa dhe si nxënësit mund të arrin të përvetësojnë leximin për komunikim.

**Fjalët çelës:** *lexim, komunikim, gjuhë, kurrikulë, nxënës.*

### Abstract

This article aims to present the importance of reading as one of four main linguistic skills, together with speaking, writing and listening, impacting greatly the development of student's communication skills. In the Albanian Language and Literature Curriculum, starting from grade I-XII *Language and Communication* composes a special part. This is why this article strives to reflect via tables the number of classes and knowledge distribution on this field throughout four years of studying, for general gymnasium high school streams. Such graphic representation serves to enable comparisons between the number of hours and lines and sub-lines presented within the field *Language and Communication*. A comparison of such nature dictates certain conclusions and recommendations on the quantity and manner that would assist students to acquire reading for communication.

**Key words:** *reading, communication, language, curriculum, student.*

---

### Hyrje

Çdo njeri gjatë jetës së tij ka pasur mundësi të shumta të ndeshet me leximin e gazetave, revistave, librave, artikujve shkencore dhe teksteve nga fusha të larmishme të dijes, shkencës dhe kulturës, aq sa të mendojë se përkufizimi i leximit do të ishte çështja më e thjeshtë. Megjithatë, ekzistojnë këndvështrime të ndryshme lidhur me atë se çfarë është leximi, dhe meqë leximi ka domethënie të shumta për njerëz të ndryshëm një përkufizim i thjeshtë nuk mund t'i përmbledh saktësisht të gjitha aspektet e tij.

"Leximi është kryesisht një proces deshifrimi ku koduesi e paraqet mesazhin përmes një kodi, kurse deshifruesi e deshifron dhe e kupton atë. Aktiviteti i leximit përfshin perceptimin, ruajtjen në kujtesë, arsyetimin, vlerësimin, imagjinatën, organizimin, zbatimin dhe trajtimin e pikave problematike".<sup>155</sup>

Sipas psikologjisë së të mësuarit, "leximi është proces i transformimit të fjalës së shtypur në të folur dhe e të kuptuarit të saj nga ai që e lexon, si dhe i këtyllë përdoret si mjet dhe mënyrë e të mësuarit aktiv. Në këtë kontekst, leximi e transformon fjalën e shtypur në të folur, dimensionet e saj optike-vizuale i shndërron në dimensione fonike-auditive dhe bën të mundur kuptimin, përjetimin dhe interpretimin e saj nga ai që e lexon (ose që e dëgjon) atë fjalë të shtypur (leximin e saj)".<sup>156</sup>

Gaston Milaret e përkufizon leximin kështu: "Të dish të lexosh, do të thotë të jesh i aftë ta transformosh një mesazh të shkruar në një mesazh sonor (tingullor,) duke ndjekur disa rregulla të përcaktuara, të kuptosh përmbajtjen e mesazhit të shkruar, si dhe aftësia për të gjykuar dhe vlerësuar vlerat estetike."<sup>157</sup>

Bazuar në përkufizimet e lartpërmendura, të lexuarit duhet të konceptohet si një proces brenda së cilit nxirren mesazhet nga teksti, lexuesit lidhin format grafike me përvojën e tyre dhe ndihmojnë në nxjerrjen e kuptimit specifik prej kuptimeve të shumta që mund të ketë teksti. Mirëpo, jo gjithmonë secili lexues arrin ta realizojë me sukses këtë proces. Shumë njerëz besojnë se aftësia për të realizuar procesin e leximit është marrë qysh në fillimet e jetës së tyre arsimore, pra që në fëmijëri, megjithatë leximi është një proces që nis në fëmijëri por vijon përgjatë gjithë jetës. *Ka nxënës që arrijnë t'i përmbushin kërkesat e të lexuarit në shkollë, shumë të tjerë dështojnë në përpjekjet e tyre për të kuptuar atë çka ata ndeshin në materialet e shtypura*<sup>158</sup>. Kjo ndodh se leximi sikurse gjithë gjërat e tjera bëhet në mënyra të ndryshme, mund të lexojmë në mënyrë thelbësore apo sipërfaqësore, ngadalë ose shpejt, duke u menduar në lidhje me atë që e lexojmë ose duke mos u lodhur fare për porosinë që na jep teksti.

Mënyra e të lexuarit tonë varet nga interesi dhe përvoja jonë jetësore: lexuesi i ri dhe pa përvojë, natyrisht që nga teksti do të nxjerrë shumë më pak porosi se sa një lexues me më shumë përvojë, i cili ka një pjekuri më të madhe jetësore. Kur lexuesi futet në fshehtësitë e leximit arrin t'i identifikojë porosit, idetë, kuptimin e fshehtë ose shumëkuptimësinë që jep autori. Pra, persona të ndryshëm lexojnë në mënyra të ndryshme, por për të realizuar një leximi efikas, lexuesi duhet të nxjerr kuptimi e tekstit që lexon dhe të ndërtojë pasqyrime mendore të asaj që ai ka kuptuar, me qëllim vënien e tyre në përdorim, pra arritjen e komunikimit.

Studiues të ndryshëm kudo në botë e kanë trajtuar leximin nga këndvështrime të ndryshme, por të gjithë kanë qenë në një mendje në lidhje me idenë, se qëllimi kryesor i leximit është realizimi i kuptimit të tij, pasi nuk mund të flitet për lexim nëse nuk kuptohet ajo që lexohet. Andaj, lexuesit duhet të ushtrohet në tri nivele: *në nivelin e parë prozaik* lexuesi kupton se ç'ka thënë autori, ai është në gjendje të lexojë rreshtat. *Në nivelin e dytë interpretativ* lexuesi është i aftë të kuptojë se ç'ka dashur të thotë autori, ai është në gjendje të lexojë përmes rreshtave. *Në nivelin e tretë ose aplikativ* lexuesi mund të zbatojë idenë e autorit në situata të reja apo të ndryshme, pra ai është në gjendje të lexojë përtej rreshtave.

<sup>155</sup> Dechant, Emerald. 1991. Understanding and Teaching Reading: An Interactive Model. Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.

<sup>156</sup> Riza Brada, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore, botimi III i plotësuar*, Pejë, 2005, f. 391.

<sup>157</sup> Gaston Milaret, *Pedagogjia e përgjithshme*, Tiranë, 1995, f. 34.

<sup>158</sup> Bardhyl Musai, *Mësimdhënia dhe të nxëniti ndërveprues*, Tiranë, botimi i dytë, 2021, f.15.

Nëse mësimdhënësi arrin t'i aftësojë nxënësit që hap pas hapi t'i realizojnë të tri niveleve e kuptimit, lexim për të gjetur idenë kryesore, lexim për të shquar detajet mbështetëse, lexim për të identifikuar modelet organizuese të idesë dhe detajeve, lexim për t'u përdorur ajo çka është lexuar dhe leximi për të menduar rreth asaj që lexohet, atëherë mund të pretendojmë se leximi është realizuar me sukses, sepse nxënësi ka arritur të kuptojë thelbin e tekstit që ka lexuar, pra është në gjendje të integrojë përvojat e tij me njohuritë e reja.

\* \* \*

Në jetën e përditshme, ne lexojmë, shkruajmë, dëgjojmë dhe flasim duke ndërthurur katër aftësitë gjuhësore (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit) dhe komponentët e gjuhës (fjalorin, gramatikën dhe shqiptimin), një domosdoshmëri që për të komunikuar me të tjerët kërkon të përdorim integrimin e katër aftësive dhe jo përdorimin e tyre të izoluar nga njëra-tjetra. Komunikim do të thotë ta përdorësh gjuhën brenda një konteksti të caktuar shoqëror. Të jesh në gjendje të komunikosh diçka nuk do të thotë thjesht të kesh aftësi gramatikore, por nevojë për aftësinë komunikuese. Të komunikosh do të thotë të dish se kur dhe ku të thuash diçka për dikë.

Në Kurrikulën e Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë<sup>159</sup>, që nga klasa e parë e ciklit fillorë fusha *Gjuhë dhe komunikim* zë një vend të veçantë, brenda saj është përfshirë edhe leximi si aftësi që ka për qëllim të rrisë aftësinë komunikuese të nxënësit. Për këtë arsye, që në tekstet e para shkollore përshkrimi i nivelit të leximit përfshin llojin e nivelit të shprehive që nxënësit zotërojnë në bazë të niveleve, që përcaktohen si nivel i ultë dhe nivel i lartë gjuhësore, të cilët natyrisht se përfitohen nga klasa në klasë. Sipas kurrikulës në çdo nivel leximi nxënësi duhet të ekspozohet në shembuj komunikues dhe funksionalë të gjuhës sipas nivelit gjuhësor të tyre. Kjo do të thotë që leximi nuk duhet të kryhet thjesht si proces, por duhet të jetë sa më komunikativ që t'i krijojë hapësirë nxënësi, ta përdorë leximin për komunikim.

Në nivelin e ulët, pritet që nxënësi të lexojë dhe të kuptojë fjalë, togfjalësha të shkurtër, të cilët paraqiten në një kontekst të njohur e kjo ka të bëjë me leximin e kuptimtë në një kontekst të dhënë. Në nivelin e lartë, nga nxënësit pritet që të kuptojnë një larmi formash të gjuhës së shkruar, në këtë mënyrë ata do t'i përdorin këto njohuri për të lexuar tekste më të vështira me një gjuhë më komplekse duke dalluar qëndrimet dhe emocionet.<sup>160</sup>

Me përdorimin e metodës tradicionale, leximi kishte për qëllim që nxënësit të lexonin nivele të larta gjuhe. Në ditët e sotme ku synohet realizimi i mësimdhënies me përdorimin e metodave bashkëkohore (metodave që kanë në qendër nxënësin) qëllimi i mësimdhënies së leximit është përvetësimi i aftësisë komunikuese. Komunikimi cilësohet si pjesë e pandarë e detyrave në të cilat pjesëmarrësit angazhohen në ndërveprim, marrje, prodhim, kuptim ose ndërmjetësim. Natyra e detyrave mund të jetë e larmishme dhe të kërkojë shumë ose pak veprimtari gjuhësore. Ato mund të jenë krijuese si p.sh., shkrimi, zgjidhja e problemit, interpretimi i një roli, pjesëmarrja në një diskutim, leximi i një mesazhi etj.

Për të realizuar detyra komunikimi, nxënësit duhet të marrin pjesë në veprimtari gjuhësore komunikative dhe të jenë ndërveprues. Për të zhvilluar aftësinë komunikuese, veprimtaritë e leximit të dhëna në klasë apo si detyra shtëpie, duhet të përmbajnë detyra si në jetën reale që përfshijnë komunikimin e kuptimtë.

---

<sup>159</sup> [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Koncepcija-albanski\\_jazik.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Koncepcija-albanski_jazik.pdf), f.14, shkarkuar më 20.01.2023.

<sup>160</sup> Grup autorësh, *Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve moderne për Arsimin Parauniversitar*, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Tiranë, 2000, f. 12.

Për të praktikuar leximin, pra për ta përdorur atë informacion që e merr edhe jashtë klase, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të lexojnë pa u ndërprerë një libër, gazetë, revistë apo ndonjë pjesë tjetër teksti brenda një periudhe të caktuar kohore. Por leximi i pavarur nuk është i mjaftueshëm për të përvetësuar këtë aftësi gjuhësore, nëse mësimdhënësi nuk merr informacion kthyes nga nxënësi. Kjo do të thotë, se nxënësve duhet t'u jepet mundësia për të folur, për të shprehur idetë e tyre mbi tekstin ose veprën që e kanë lexuar, që të kalojnë të kuptuarin e tyre në nivele më të larta të zhvillimit të mendimit dhe për këtë kanë nevojë për një praktikë të udhëzuar nga ana e mësuesit. Kjo mënyrë e tillë leximi ndihmon nxënësit të përvetësojnë rrjedhshmërinë në të folur. Nxënësit duhet të inkurajohen të praktikojnë leximin e pavarur, sepse në këtë mënyrë ata ndjehen më të motivuar, kanë një qëllim, përcaktojnë të nxënit e tyre dhe janë më ndërveprues.

Zhvillimi i leximit duhet të përmbajë detyra që kërkojnë të kuptuarin e përmbajtjes, ashtu edhe detyra komunikative që kërkojnë përdorimin e ideve të nxjerra nga teksti. Detyrat e leximit që kanë për qëllim të rrisin aftësinë komunikuese, duhet të jenë të orientuara në mënyrë të atillë, që të rrisin besimin e nxënësve në aftësinë e tyre për të lexuar. Zhvillimi i detyrave në një pjesë leximi ofron pyetje të thjeshta për të kontrolluar sa është kuptuar teksti, prandaj lind nevoja që mësimdhënësi të gjejë strategji të reja për t'u krijuar mundësinë nxënësve të komunikojnë më shumë.

Përpara se të jepet një detyrë leximi, duhet të planifikohet mirë rritja e aftësive komunikuese nga ana e nxënësve, prandaj ora e mësimit duhet të jetë e orientuar mirë për të rritur besimin e nxënësve tek aftësitë e tyre për të lexuar. Për këtë qëllim para se të japë një detyrë mësimdhënësi duhet të ndjekë disa hapa:

- Krijimi i një detyre leximi rreth një çështjeje me rëndësi për nxënësit. Merret informacioni kthyes nga nxënësit për të parë sa është kuptuar qëllimi i leximit: më pas lexohet për të marrë informacion të përgjithshëm, apo për të marrë informacion specifik, në këtë mënyrë nxënësit përcaktojnë strategjitë e tyre për arritjen e qëllimit final.

- Përcaktimi i qëllimit të veprimtarisë dhe pritshmërinë. Kjo varet nga lloji i qëllimit, si për shembull do të kontrollohet gramatika apo fjalori, apo praktikimi i strukturave të caktuara më parë me anë të leximit.

- Kontrolli i nivelit të vështirësisë së tekstit në lidhje me gjuhën e përdorur, udhëzimet, mjetet ndihmëse etj.

Përdorimi i fazës para përgatitore të leximit është i rëndësishëm për përgatitjen e nxënësve për kryerjen e detyrës. Gjatë kësaj faze mësuesi mund të përdorë strategji dhe teknika të tilla si: lidhja e njohurive të marra me temën dhe përmbajtjen gjuhësore të tekstit; aktivizimi i njohurive të nevojshme për të kuptuar tekstin; njohja e nxënësve me qëllimet e leximit të pjesës së dhënë; përdorimi i punës në grup ose çift për veprimtaritë e ligjërimit me gojë etj. Teknikat që mund të përdoren gjatë kësaj faze janë: stuhi mendimesh, përdorimi i objekteve konkrete, puna me çifte për të lidhur njohuritë e marra me temën që do diskutohet, tabela për të ndarë konceptet etj.

Për t'i konkretizuar mendimet dhe idetë e lartpërmendura do të na shërbejnë kurrikulat e gjuhës shqipe dhe të letërsisë për katër vitet mësimore për arsimin e mesëm të lartë- drejtimi i gjimnazit. Pas një analize të hollësishme që i bëmë pjesë së gjuhës, të dhënat që nxorëm i kemi pasqyruar në mënyrë tabelore ku kemi paraqitur fushat dhe nënfushat që mësohen, sasinë dhe ndarjen e orëve. Kjo paraqitje tabelore do të na shërbejë për të bërë krahasime dhe për të arritur në përfundimin, se sa dhe si nxënësit mund të arrin të përvetësojnë leximin për komunikim me ndihmën e njohurive të marra nga kjo fushë përgjatë katër viteve mësimore.

<b>Gjuhë dhe komunikim</b>	<b>Viti I</b>	<b>Viti II</b>	<b>Viti III</b>	<b>Viti IV</b>
Të shprehurit dhe krijimtaria	30 orë	30 orë	30 orë	30 orë
Njohuri të përgjithshme për gjuhën	9 orë		5 orë	3 orë
Fonetikë	5 orë			
Leksikologji		7 orë		4 orë
Morfologji	15 orë	20 orë		8 orë
Sintaksë	5 orë	13 orë	25 orë	
Dialektologji				4 orë
Stilistikë				15 orë
Drejtshkrimi			5 orë	
Lektyrë	10 orë	10 orë	10 orë	10 orë
<b>Gjithsej</b>	<b>74 orë</b>	<b>80 orë</b>	<b>75 orë</b>	<b>74 orë</b>

Nga pasqyra tabelore e mësipërme, na bie në sy një ndarje korrekte e njohurive gjuhësore, ku njohuritë rimerren brenda katër viteve mësimore me një sasi pak a shumë të përafërt orësh. Pjesa e gjuhës përmbledh në vete fushën *Të shprehurit dhe krijimtaria*, me një fond prej 30 orësh për vitin e parë, ndërsa njohuritë gjuhësore janë planifikuara me 34 orë, ndërsa 10 orë janë ndarë fushës së lektyrës, që në total japin shumën prej 74 orëve. Në vitin e dytë njohuritë gjuhësore janë të planifikuara me një fond prej 40 orësh, të shpërndara sipas fushave (leksikologji, morfologji dhe sintaksë) që bashkë me fushën *Të shprehurit dhe krijimtaria* formojnë një total prej 70 orëve, ndërsa fusha e lektyrës është planifikuar të punohet me 10 orë. Shuma e përgjithshme e orëve për fushën *Gjuhë dhe komunikim* për vitin e dytë arrin në 80 orë.

Vitin e tretë janë të ndara 35 orë vetëm për pjesën e gjuhës dhe 30 orë për fushën *Të shprehurit dhe krijimtaria*, ndërsa 10 orë përfshin fusha e lektyrës, që në total arrin shumë 75 orë. Ndërsa vitin e katërt janë planifikuar 34 orë për pjesën e gjuhës dhe 30 orë për fushën *Të shprehurit dhe krijimtaria*, ndërsa 10 orë zë fusha e lektyrës, që në tërësi formojnë shumë prej 74 orëve mësimore. Në vështrim të parë ky planifikim i orëve që rezulton në kurrikulën e Gjuhës shqipe dhe të letërsisë nga ana teorike mund të na duket i arsyeshëm, por sa arrin të realizohen dhe përvetësohen me sukses në praktikë të gjitha njohuritë e marra nga nxënësi, kjo është një çështje tjetër tek e cila çalon vite me radhë sistemi ynë arsimor.

Sipas kurrikulës njohuritë gramatikore që mësohen, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit janë të integruara me studimin e teksteve *përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, paraqitëse*, pra ekziston një gërshetim i njohurive teorike në praktikë. Në këtë vazhdë, në praktikë na paraqitet një çështje shqetësuese te fusha *Të shprehurit dhe krijimtaria*, e cila është planifikuara të realizohen me 120 orë mësimore brenda katër viteve mësimore, ku synohen të punohen tema të ndryshme të lira, për të ardhur në shprehje sa puna e pavarur krijuese, aq edhe pasurimi i fjalorit dhe formimi i një stili sa më të lartë gjuhësor.

Kujtojmë, se temat e përzgjedhura nga kjo fushë nuk i përgjigjen nivelit, interesimit dhe kërkesave të nxënësve, me një fjalë nuk arrin ta tërheqin vëmendjen e nxënësit për lexim aktive krijuese dhe kritike. Shumë informacione jepen në mënyrë teorike, nuk ekziston një harmonizim orësh në mes teorisë dhe praktikës, si rrjedhojë shumë njohuri nxënësi duhet t'i mësojë përmes kujtesës mekanike. Pra, paraqitja e teksteve të ndryshme *përshkrues, argumentues, rrëfyes udhëzuese, paraqitëse* etj., që kanë për bazë aftësimin e nxënësve për të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit, mungon, si rezultat i saj nuk mund të pretendojmë realizimin e një lexim të kuptimshëm, që do të ndikojë në rritjen e aftësisë së komunikimit.

Edhe në fushën e lektyrës vihet re një kundërvënie dhe mosharmonizim mendimesh. Nga paraqitja tabelore e lartpërmendur, fusha e lektyrës në kurrikulat e gjuhës shqipe dhe të letërsisë për katër vitet e arsimit të mesëm të lartë është planifikuar të punohet me 10 orë brenda çdo viti shkollor. Kjo sasi orësh mendojmë se është e pamjaftueshme, kur e dimë se për fushën lektyrës që nga klasa I-XII, nxënësi është i detyruar të lexojë dhe interpretojë e një vepër letrare brenda çdo muaji. *A mundet mësimdhënësi me nxënësit ta përpunojnë dhe interpretojnë një vepër letrare brenda një ore mësimore ?*

Referuar kurrikulave me të cilat punohet sot, mësimdhënësi e interpreton lektyrën vetëm brenda një ore mësimore prej 40 min. Kohë që e kufizon nxënësin dhe pamundëson realizimin e qëllimi të leximit të lektyrës dhe marrjen e informacionit kthyes nga mësimdhënësi, meqenëse, gjatë orës së interpretimit të lektyrës nxënësit duhet t'i jepet mundësia të flas, të lexojë, të komentojë, të interpretojë, të debatojë, të shpreh mendimin e tij lidhur me veprën që ka lexuar, të nxjerrë idenë e tekstit përmes detyrave të ndryshme komunikative. Me një fjalë, nxënësit duhet të bashkëveprojnë mes veti, duke përdorur strategji të ndryshme mësimore që i çojnë ata drejt një leximi me kuptim, i cili do të ndihmojë në realizimin e aftësisë komunikative, pra të aftësohen të lexojnë jo vetëm në nivelin e ulët por edhe në nivelin e lartë gjuhësor.

Leximi i lektyrave sjellë dobi në përmirësimin e aftësive të të folurit, kështu, sa më shumë që lexojnë nxënësit, aq më shumë përmirësohen në aftësinë e tyre të të folurit dhe të të shkruarit, për shkak se janë duke u ekspozuar ndaj formacioneve dhe funksioneve të ndryshme të një fjalie, duke e bërë këtë, lexuesit kuptojnë se ata janë të aftë të mësojnë gramatikën dhe fjalorin e gjuhës. Realizimi me sukses i gjithë aktiviteteve gjatë orës së interpretimit të lektyrës në klasë kërkon kohë dhe liri në shprehjen e mendimit dhe jo kufizim. Në qoftë se mësimdhënësi e kufizon nxënësin duke e nxituar (fol më shpejtë se nuk kemi kohë, mbaroi ora) në atë mënyrë ia ndikon negativisht, sepse ia ndal rrjedhën e mendimit dhe të shprehurit nxënësit. Për të ndikuar sadopak në të mirë të kësaj situatë, sugjerojmë një rritje të fondit të orëve gjatë interpretimit të lektyrës në klasë, që nxënësit të jenë të lirë për të komunikuar dhe për të ndërvepruar në lidhje me atë që kanë lexuar.

## **Përfundim**

Nga sa u tha më lart mund të përfundojmë, se nga të katër aftësitë gjuhësore (të folurit, të lexuarit, të shkruarit dhe të dëgjuarit) leximi është aktiviteti më i rëndësishëm intelektual dhe edukativ, sepse është jo vetëm aftësi komunikative por edhe mjet për përvetësimin e gjuhës. Leximi si aktivitet që të përvetësohet me sukses nga nxënësi duhet të realizohet në tri nivele: në nivelin e parë gjatë leximit të një teksti nxënësi i lexon rreshtat e shkruar, pra kupton ç'ka ka thënë autori; në nivelin e dytë nxënësi lexon përmes rreshtave, pra është i aftë të kuptojë se ç'ka dashur të thotë autori, dhe në nivelin e tretë, lexon përtej rreshtave, pra është në gjendje të zbatojë idenë e autorit në situatë të ndryshme.

Konkluzioni ynë është se leximi si aftësi ka për qëllim arritjen e komunikimit, sepse suksesi i vërtetë në mësimdhënie dhe mësimnxënie e gjuhës është kur nxënësit arrijnë të komunikojnë në gjuhën standarde brenda dhe jashtë klasës. Mirëpo, kurrikula jonë e arsimit të mesëm të lartë nuk ishte edhe aq premtuese në këtë drejtim, nga pasqyra tabelore që paraqitëm u vu re, se pjesa teorike e fushës *Gjuhë dhe komunikim* është brenda kuadrit të planifikuar të lëndës, mirëpo zbatimi në praktik i kësaj fushe çalon. Paraqitja e teksteve të ndryshme *përshkrues, argumentues, rrëfyes udhëzuese, paraqitëse* etj., që kanë për bazë aftësimin e nxënësve për të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit, mungon, si rezultat i saj nuk mund të pretendojmë realizimin e një leximi të kuptimshëm që do të rrit aftësinë e komunikimit.

Në të njëjtën linjë është zhvilluar edhe fusha e lektyrës, tek e cila vjen në shprehje më shumë se kudo tjetër aftësia e leximit të pavarur dhe komunikimi gjatë orës së interpretimit të saj. Andaj, sugjerojmë një rritje të numrit të orëve, që nxënësit të kenë mundësi që interpretimin e saj ta realizojnë brenda dy orëve mësimore në klasë, që t'u jepet kohë dhe mundësi të zhvillojnë aftësinë komunikuese duke debatuar, analizuar situata të ndryshme që kanë hasur në vepër, duke përçuar mendime dhe ndjenja të tjerët dhe duke nxjerrë përfundime dhe ide nga më të ndryshmet.

## Referencat

- [1]. Alderson Ch. 1984. *Reading in a foreign language: a reading problem or a language problem*, London.
- [2]. Brada R. 2005. *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore, botimi III i plotësuar*, Pejë.
- [3]. Dechant E. 1991. *Understanding and Teaching Reading: An Interactive Model*. Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
- [4]. Grup autorësh (2000), *Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve moderne për Arsimin Parauniversitar*, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Tiranë.
- [5]. Grup autorësh (1998), *Studio gjithçka, arsyes - vendin e parë, Modele për mësimdhënie të suksesshme*, AEDP, Soros, Tiranë.
- [6]. Grup autorësh (2001), *Modele për mësimdhënie të suksesshme*, Tiranë.
- [7]. Gjokutaj, Mimoza (2009), *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- [8]. Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (2006), Filara.
- [9]. Krashen, Stephen D. (1981), *Second Language Acquisition and Second Language Learning*, Oxford.
- [10]. Mato, E. & Kamani, P. (2006), *Strategjitë e të lexuarit*, Tiranë.
- [11]. Musai B. 2021. *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues*, Tiranë.
- [12]. Wallace, C. (1992), *Reading*, Oxford University Press.
- [13]. Woolfolk, A. (2011), *Psikologjia e edukimit*, botimi i njëmbëdhjetë, Tiranë.
- [14]. [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Koncepcija-albanski\\_jazik.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Koncepcija-albanski_jazik.pdf), f.14, shkarkuar më 20.01.2022.
- [15]. [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna\\_programa\\_Albanski\\_jazik\\_i\\_literatura-I\\_GO-alb.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna_programa_Albanski_jazik_i_literatura-I_GO-alb.pdf)
- [16]. [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna\\_programa-Albanski\\_jazik\\_i\\_literatura-II\\_GO-alb.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna_programa-Albanski_jazik_i_literatura-II_GO-alb.pdf)
- [17]. [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna\\_programa-Albanski\\_jazik\\_i\\_literatura-III\\_GO-alb.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna_programa-Albanski_jazik_i_literatura-III_GO-alb.pdf)
- [18]. [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna\\_programa-Albanski\\_jazik\\_i\\_literatura-IV\\_GO-alb.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2018/02/Nastavna_programa-Albanski_jazik_i_literatura-IV_GO-alb.pdf).